



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.78/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi kryesues, Afijete Sada-Gillogjani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me apelin e Sabit Ramadani, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 22.09.2019, mori këtë:

VENDIM

LEJOHET tërheqja e apeli A.nr.78/2019 e datës 20.09.2019, e parashtruar nga Sabit Ramadani.

Arsyetim

Sabit Ramadani me datën 20.09.2019 ka paraqitur apel në PZAP Anr.78/2019, me të cilin ka kërkuar që të bëhet regjistrimi në listën votuesve jashtë vendi.

Me datë 20.09.2019, apeluesi ka parashtruar kërkesën me nr. Protokolli 78/3 për tërheqjen e apelit Anr.78/2019 të datës 20.09.2019 me arsyetimin se pas konsultimit me zyrtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), emri i tij figuron në listën e votuesve brenda vendi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës, në kuptim të nenit 115.1 të LZP – së, PZAP dhe në kuptim të nenit 11 paragrafi 2 të Rregullës Nr.02/2015 të PZAP-it parashihet se *Deri në marrjen e vendimit kryesor, për shqyrtimin e apelit, palët mund të tërheqin apelin e parashtruar*, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.78/2019 më datën 22.09.2019.

